



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:225242
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05755473

Pml.nr.302/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar, Agim Maliqi dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit F. R., për shkak të veprës penale përdorimi i paautorizuar i pasurisë nga neni 420 lidhur me nenin 77 të Kodit penal të republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.43/2023 të datës 04.12.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.158/2024 të datës 12.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 28 maj 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit F. R. e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.43/2023 të datës 04.12.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.158/2024 të datës 12.04.2024.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.43/2023 e datës 04.12.2023, të dënuarin F. R. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale përdorimi i paautorizuar i pasurisë nga neni 420 lidhur me nenin 77 të KPRK-së duke e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 100 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej 50 €, në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, kurse përfaqësuesi i palës së dëmtuar nuk kishte paraqitur kërkesë pasurore juridike.

Me të njëjtin aktgjykim i dënuari në kuptim të nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së është liruar nga akuza për dy vepra penale përdorimi i paautorizuar i pasurisë nga neni 420 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.158/2024 e datës 12.04.2024, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit duke ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me vendimin për dënim në atë mënyrë që për veprën penale të shpallur fajtor e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muaj, kurse ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë është refuzuar si e pabazuar.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit F. R., avokati Adem Vokshi nga P., për shkak të shkeljes së ligjit penal lidhur me lartësinë e sanksionit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshoj aktgjykimet e kundërshtuara dhe të dënuarit ti shqipton dënim me kusht apo me të holla.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.173/2024 e datës 23.05.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje të ligjit penal, meqë përkundër faktit se i dënuari kishte bërë pranimin e fajësisë që në fazën e hershme të procedurës penale, por gjykata nuk e kishte miratuar një pranim të tillë me arsyetimin se nuk ishin plotësuar kushtet ligjore pasi që kishte pranuar veprat penale të kryera me datat 20.03.2021 dhe 21.03.2021, kurse nuk kishte pranuar edhe dy vepra tjera të kryera me datat 12.04.2021 dhe 17.04.2021 e që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor pikërisht për këto dy vepra penale ishte liruar nga akuza.

Pretendohet se gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë vetëm kanë marrë si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë për këto vepra penale por nuk kanë çmuar edhe rrethanat tjera se i dënuari ka bashkëpunuar me policinë dhe sinqeritetin e tij me organet e ndjekjes dhe gjykatën. Për më tepër, dënimi me burgim efektiv pretendohet se nuk do të shërbej fare qëllimit të dënimit pasi që natyra e kësaj vepre penale dhe personaliteti i të dënuarit nuk e arsyetojnë shqiptimin e këtij lloji të dënimit. Kjo për faktin se dispozita ligjore ka përcaktuar dënim me gjobë ose me burgim dhe dënimi me burgim për këtë vepër penale duhet të zbatohet në rastet kur dënimi me gjobë nuk është i mjaftueshëm për arritjen e qëllimit të dënimit. Kurse në rastin konkret duke pasur parasysh rrethanat personale të të dëmtuarit se është baba i tre fëmijëve dhe që për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, duke shprehur keqardhje dhe duke premtuar se nuk do të përsëris veprimet të tilla, e posaçërisht faktin se nuk është shkaktuar dëm të dëmtuarës, atëherë do të duhej të shqiptohej dënim më i butë, përkatësisht dënim me gjobë apo dënim të kushtëzuar.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të pabazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

Duke vlerësuar pretendimet përkitazi me vlerësimin e rrethanave me rastin e shqiptimit të dënimit, Gjykata Supreme e Kosovës vëren faktin se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal nga të dy gjykatat e instancave më të ulëta dhe të dënuarit i është shqiptuar dënimi i përcaktuar brenda kornizës së minimumit dhe maksimumit të dënimeve të përcaktuara për veprat penale për të cilat i dënuari është shpallur fajtor. Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385 par.5 të KPP-së kur është fjala për vendimin për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, shkelja e ligjit penal bëhet në rastet kur në marrjen e vendimit për dënim gjykata i ka tejkuluar kompetencat ligjore. Pra, nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimit të shqiptuar, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkuluar kompetencat ligjore dhe arsyet e dhëna për vendimin për dënim, nuk janë të përfshira në shkelje procedurale. Për më tepër, në aktgjykimet e kundërshtuara është çmuar si rrethanë lehtësuese fakti i pranimit të fajësisë nga ana e të dënuarit edhe pse për arsye procedurale ky pranim nuk ishte aprovuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Megjithatë konstatimet e theksuara në aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta gjyqësore përkitazi me rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe qëllimin e dënimit të shqiptuar i aprovon në tërësi edhe kjo gjykatë.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.302/2024, më 28 maj 2024

B.profesional,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Rasim Rasimi